



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:149001

Datë: 03.10.2024

Numri i dokumentit: 06249126

K.DH.SH.II.nr.1795/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Franciska Zhitija Ymeri kryetare e kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Faton Bajrami, anëtarë të kolegjit, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit “Dijari Estate”Sh.a me NUI811107912 dhe me seli në Rrugën Ismajl Qemajli p.nr në Vushtrri, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson “Juris Guard Law Firm” Sh.p.k në Prishtinë, kundër të paditurës-kundërpropozuesi, Inspektoratit Qendror të Punës me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim i vendimit, me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.319/24 të datës 01.08.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 03.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditësit-propozuesi “Dijari Estate”Sh.a me NUI811107912 dhe me seli në Rrugën Ismajl Qemajli p.nr në Vushtrri, ndërsa VËRTETOHET Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.319/24 të datës 01.08.2024.

A r s y e t i m i

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, është vendosur si në vijim;

“REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesa e paditësit “Dijari Estate” Sh.a me NUI811107912 për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit me numër të protokollit 131 të datës 18.04.2024 të Komisionit të Organit të Shkallës së Dytë të Inspektoratit të Punës derisa gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor lidhur me padinë e paditësit.”

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë e paditësi përmes të autorizuarit të tij, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa e paditësit dhe të ndryshohet aktvendimi KA.nr.319/2024 i datës 01.08.2024 apo çështja ti kthehet në rigjykim shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi-propozuesi “Dijari Estate” Sh.a me NUI811107912 dhe me seli në Rrugën Ismajl Qemajli p.nr në Vushtrri, pranë Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, ka iniciuar konflikt administrativ kundër të paditurit Inspektorati Qëndror i Punës me seli në Prishtinë, ndaj vendimit nr.131 të datës 18.04.2024. Paditësi së bashku me padi, ka propozuar - kërkuar edhe shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ përfundimtar - vendimit me nr.131 të datës 18.04.2024, të paditurit Inspektorati Qëndror i Punës me seli në Prishtinë.

Dhoma e Shkallës së Parë ka marrë aktvendimin e ankimuar me arsyetim se, nga propozimi - kërkesa për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të të paditurës dhe shkresave tjera të lëndës, pas shqyrtimit të pretendimeve të paditësit, si parashtrues i kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të goditur, dhe provave të bashkëngjitura asaj kërkesë, gjykata vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet nga neni 22 para. 2 lidhur me para. 6 të LKA-së për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ. Për gjykatën nuk është vërtetuar se paditësit do t'i shkaktohej dëm vështirë i riparueshëm nëse ekzekutohet vendimi i goditur, si kusht i parë për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ. Gjykata gjen se pretendimet e paditësit nuk lidhet me gjobë e shqiptuar, e cila është vërtetuar me vendimin e goditur, por me ndalimin e procesit të punës në vendin e kryerjes së punimeve ndërtimore, si dhe pasojat që shkaktohen nga ndërprerja e punimeve. Në tërë kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, paditësi i ka trajtuar vetëm pasojat për shkak të ndërprerjes së punimeve dhe ka sqaruar se tani i ka ndërmarr të gjitha masat për sigurinë dhe shëndetin në punë. Përveç kësaj, paditësi nuk ka argumentuar se si shtyrja e ekzekutimit të aktit të goditur (me të cilën është shqiptuar gjobë) do të ndikonte në mundësinë që ai t'ia rifilloj punës, për derisa vendimi nr.01/12-31/2023 i datës 21.12.2023 për ndërprerjen e përkohshme të procesit të punës ende është në fuqi. Gjykata sqaron se, kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ i vlerëson vetën në raport me aktin e goditur dhe pasojat që i shkakton ai akt nëse ekzekutohet. Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se realizimi i shumës së gjobës përmes ekzekutimit të vendimit të goditur nuk paraqet dëm vështirë të riparueshëm, pasi ai shpërblehet në të holla, rrjedhimisht ky dëm riparohet tërësisht në momentin kur paditësit i paguhen (kthehen) të hollat për dëmin e njohur (eventualisht). Për më tepër, i padituri paraqet autoritet publik, obligimet financiare së të cilit mbulohen nga buxheti shtetëror, rrjedhimisht paditësi do të kishte mundësi që në rrugë ligjore ta realizoj shpërblimin eventual të dëmit pa rrezik nga falimentimi i të paditurit ose nga paraqitja e ndonjë rrethana e cila do t'i vështirësonte atij shpërblimin e dëmit eventual. Gjykata e gjen të pa provuar pretendimin e paditësit se, me ekzekutimin e aktit administrativ të goditur do të shkaktoheshin borxhe të reja dhe të papërbalueshme në raport me kontrata me palët e treta. Ai nuk e ka paraqitur asnjë provë, nga e cila do të rezultonte se me ekzekutimin e aktit administrativ të goditur, atij do t'i shkaktoheshin detyrime të reja në raport me palë tjera.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, nga se edhe

sipas vlerësimit të kolegjit, në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit 03.L-202 për Konfliktet Administrativ.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Në rastin konkret paditësi, me propozimin e ushtruar, kërkon që të caktohet shtyrja e ekzekutimit të vendimit nr.131 të datës 18.04.2024, e lëshuar nga e paditura, deri në vendosjen meritorë të kërkesëpadisë lidhur me këtë lëndë.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të paditësit, në ankesë ndaj aktvendimit të Dhomës së Shkallës së Parë, Kolegji vlerëson se të njëjtat janë jo të qëndrueshme, të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa dhe për tu lejuar shtyrja e ekzekutimit të vendimit të ankimuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase edhe vlerësimi i Kolegjit është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së. Sepse, kërkesa tërësisht është e mbështetur në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe pretendimet me të cilat gjykata do të vendosë në mënyrë meritorë pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë për Departamenti për Çështje Administrative në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së propozuesit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurit, me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar. Meqë në këtë rast paditësi, nuk ka bërë të besueshme pretendimet se janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, e me të cilin do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit duke ju referuar dispozitave ligjore, të nenit 22 par.2 të LKA-së. Prandaj, pretendimet ankimore janë të paqëndrueshme sepse nga provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës siç janë; vendimi i atakuar, kontrata për punë të vrazhda të datës 04.07.2023, njoftimi për marrjen e Unirefit dhe pagesës së

gjobës të datës 26.04.2024, ankesa e paditësit ndaj vendimit të shkallës së parë, kërkesa/mjoftimi i tij i datës 17.01.2024, raporti zyrtar Nr.01/12-29/2023-A të datës 12.01.2024, vendimi nr.01/12-31/2023 të datës 21.12.2023 të Inspektoratit të Punës, njoftimi i paditësit i datës 23.01.2024, komunikimet me e-mail nga data 30.01.2024 deri 03.05.2024, vendimi nr. 01/12-29/23/-Gj/1 i Inspektoratit të Punës në Prishtinë, si dhe disa foto nga vendi i punës, andaj dokumentet e bashkangjitura nga paditësi-propozuesi në asnjë rrethanë nuk dëshmojnë se është përmbushur kushti i rrezikut serioz dhe dëmi i riparueshëm, se ekziston rreziku i shkaktimit të dëmit apo humbjeve të tjera, nëse nuk caktohet shtyrja e ekzekutimit të vendimit kontestues, andaj edhe kolegji i kësaj gjykate gjenë se paditësi-propozuesi me prova të cilat ja ka bashkangjit kërkesës në fjalë nuk janë bindëse dhe nuk e mbështetin pretendimet e paditësit-propozuesit se ekziston mundësia e shkaktimit të dëmit apo humbje të tilla, andaj, kolegji i kësaj gjykate erdh në përfundim se propozuesi-paditësi kërkesën për shtyrje të ekzekutimit nuk e ka bërë të besushëm me prova bindëse dhe konkrete, që me ekzekutimin e vendimit kontestues do të mund të shkaktohet ndonjë dëm të riparueshëm, e cila do të mund të riparohej me vështërsi, ashtu siç parashihet me nenin 22 paragrafi 6 e lidhur me paragrafin 2 të LKA-së.

Kolegji i kësaj gjykate vlerësoj të gjitha pretendimet ankimore por gjeti se të njëjtat nuk kanë ndikim ndryshe në vendosje lidhur më këtë rast, andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr. 1795/24 datë 03.10.2024

Kryetarja e Kolegjit
Franciska Zhitija Ymeri